

LIGJ
Nr. 80/2022

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
MADHOR NË ALBANOLOGJI “ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e projektit madhor në albanologji “Enciklopedia shqiptare” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 24.11.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13880, datë 19.12.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj**

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT
MADHOR NË ALBANOLOGJI ENCICLOPEDIA SHQIPTARE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat më poshtë do të quhen *Palë*,

Të nxitura nga përgjegjësia për promovimin e përbashkët të identitetit kombëtar si trashëgimi e pandashme e popullit shqiptar;

Të shtyra nga vullneti për nxitjen e bashkëpunimit të ndërsjellë në shkencën e albanologjisë;

Në funksion të realizimit të marrëveshjes së arritur ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës për hartimin e projektit madhor *Enciklopedia shqiptare*;

Duke respektuar legjisllacionin e brendshëm në fuqi ndërmjet Palëve,
Bien dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi është financimi i përbashkët i projektit madhor në albanologji *Enciklopedia shqiptare*, vepër themelore me karakter njësues dhe promovues.

Enciklopedia shqiptare, objekt i kësaj marrëveshjeje, paraqet në mënyrë të gjithanshme dhe përpjesëtimore, mbështetur në kriterin e rëndësisë objektive historike: personalitete, ngjarje e zhvillime politike, historike, kulturore, sociale e ushtarake, të shënuara nga gjithë hapësira kombëtare shqiptare; nga ngulmimet e hershme historike dhe nga diaspora; si dhe dukuri e personalitete të huaja me kontribut për promovimin ndërkombëtar të identitetit kombëtar, të gjuhës, kulturës, trashëgimisë dhe historisë kombëtare; si dhe për mbrojtjen e çështjes shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Projekti përfshin të gjitha proceset e hartimit të veprës, prej përgatitjes deri tek shtypshkrimi.

Enciklopedia shqiptare hartohet në 10 vëllime, me një numër mesatar prej 400 faqe për vëllim.

Neni 2

Organizimi dhe zbatimi

Palët nënshkruese ngarkojnë për zbatimin e këtij projekti Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademinë e Shkencave e Arteve të Kosovës (këtu e më tej të cilësuar si *Palë zbatuese*). Për realizimin e Projektit *Palët zbatuese* bashkëpunojnë me institucionet kërkimore-shkencore publike dhe/ose me studiues të tyre. Ato kanë të drejtë të ftojnë për bashkëpunim institucione jopublike e studiues të pavarur në vendet e tyre dhe nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe diaspora.

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje *Palët zbatuese* ngrenë bashkërisht dhe me mirëkuptim redaksinë qendrore të *Enciklopedisë shqiptare*, dy redaksi vendore dhe redaksitë e fushave. Redaksia qendrore dhe dy redaksitë përkatëse bëjnë ndarjen e përgjegjësive për paraqitjen enciklopedike të botës shqiptare në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe vende të tjera. Redaksia qendrore funksionon në Tiranë, dhe mbledhjet zhvillohen në Tiranë dhe në Prishtinë.

Për hierarkinë, ndarjen e detyrave, drejtimin dhe organizimin e punës nga redaksitë, *Palët zbatuese* veprojnë sipas një Rregullore të përbashkët, e cila miratohet prej tyre jo më vonë se data 30 tetor 2022 (këtu e tutje referuar si “Rregullore”).

Neni 3

Modalitetet e financimit

Financimi i projektit bëhet nga buxheti i të dyja Palëve nënshkruese. Shuma e vënë në dispozicion për *Projektin* parashihet në Buxhetet 2023 të Palëve nënshkruese, përfshirë vitet tjera vijuese buxhetore, deri në përfundim të projektit.

Administrimi i fondeve të vëna në dispozicion për Projektin bëhet sipas një Protokollit të veçantë i nënshkruar nga Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje apo të autorizuarit e tyre, jo më vonë se me datën 30 tetor 2022. Kompensimi për personat e angazhuar nga Palët zbatuese të Marrëveshjes do jetë i barabartë.

Neni 4

Realizimi i veprës

Projekti madhor *Enciklopedia shqiptare* zbatohet brenda një periudhe 5-vjeçare, duke filluar prej datës 1 janar 2023.

Enciklopedia shqiptare konceptohet e realizohet si një vepër e hapur, e këshillueshme *online*, në plotësim të vijueshëm. Tirazhi i shtypur i saj u drejtohet bibliotekave publike të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve promovuese të identitetit shqiptar në botë, qendrave albanologjike, e më gjerë.

Neni 5

Raportimi dhe transparenca

Palët zbatuese si rregull raportojnë me shkrim për ecurinë e *Projektit* të *Palët nënshkruese* 1(një) herë në vit. Ato raportojnë gjithashtu jashtë periodicitetit kur u kërkohet nga *Palët nënshkruese*. *Palët zbatuese* i bëjnë të njohura njëra-tjetrës raportet që paraqesin në vendet e tyre.

Neni 6
Rishikimet

Çështjet e diskutueshme që mund të lindin midis *Palëve zbatuese* në realizimin e kësaj vepre zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast të mosarritjes së mirëkuptimit, *Palët zbatuese* shqetësimet e tyre i paraqesin pranë *Palëve nënshkruese*.

Neni 7
Pronësia intelektuale

Vepra madhore *Enciklopedia shqiptare* dhe arkivi shkencor që krijohet gjatë punës për hartimin e veprës janë pronësi intelektuale e të dy institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshje. Arkivi shkencor i Projektit ruhet pranë Qendrës së Botimeve Albanologjike dhe Enciklopedike dhe *Palët zbatuese* kanë të drejta të barabarta përdorimi shkencor.

Neni 8
Vazhdimësia e Projektit

Palët mund të bien dakord për financimin e përditësimit të botimeve enciklopedike me karakter kombëtar edhe pas përfundimit të veprës *Enciklopedia shqiptare*.

Neni 9
Etika në kërkim

Përgatitja e veprës, objekt i kësaj marrëveshje mbështetet në Kodin Evropian për kërkimin shkencor të miratuar nga ALLEA (*All European Academies*), në ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, në ligjin nr. 04/L-065, datë 21.10.2011, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta” në Republikën e Kosovës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse të dy vendeve.

Neni 10
Afati

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare), me të drejtë zgjatje, mbështetur në propozimet e dy *Palëve zbatuese*.

Neni 11
Hyrja në fuqi dhe plotësimi i ndryshimeve

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të së cilës *Palët* njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore për hyrjen në fuqi.

Kjo marrëveshje mund të ndryshojë nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të dy *Palëve*.

Nënshkruar në _____, më _____._____, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën *Palë*, me të njëjtën vlerë.

**Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë**

**Për Qeverinë e Republikës së
Kosovës**